VENDIM
Nr. 10, datë 9.7.2014

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR ART-KULTURË, PYLLËZIM DHE GJELBËRIM, SI DHE UJËSJELLËS - KANALIZIME, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e Ujësjellës-Kanalizimeve, në vlerën 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e Pyllëzimit dhe Gjelbërimit, në vlerën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e Artit dhe Kulturës, në vlerën 45 819 000 (dyzet e pesë milionë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, si më poshtë vijon:

a) Financimin prej 38 819 000 (tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) Lekë, sipas tabelës 3 bashkëlidhur këtij vendimi

b) Fondin prej 7,000,000 lekësh, pjesë e fondit për projekte në fushën e artit dhe kulturës për vitin 2014, të përdoret si bashkëfinancim për projektin e IPA-Adriatik "Restaurimi dhe Muzealizimi i Fototekës Marubi, në Shkodër", me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, specifikuar sipas tabelës nr. 4 që i lidhet këtij vendimi.

4. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë zhvillimore, shoqëritë sh.a. "Ujësjellës-Kanalizime", projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të paraqesin pranë sekretariateve përkatëse teknike, në Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, brenda 1 jave nga publikimi i këtij vendimi, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve, përpara çeljes së fondeve për projektet e miratuara sipas pikës 4 të këtij vendimi.

5. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë e zhvillimore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të katërmujorit të tretë të vitit 2014. Për fondet e projekteve të paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të bëjnë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njësisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas pikës 5, të këtij vendimi.

7. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Mjedisit, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

TABELA 1. PROJEKTET E UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE PËR FINANCIM NGA FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë projektit	Vlera e financimit 2014	Vlera e financimit 2015
QARKU ELBASAN					
1	Komuna Gjergjan	Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Muriqan	37,831,000	18,915,500	18,915,500
2	Komuna Gracen	Ndërtimi i ujësjellësit të Shëngjin	8,132,000	5,692,400	2,439,600
3	Komuna Kodovjat	Ndërtim KUZ, fshati Bulçar	6,973,000	4,881,100	2,091,900
4	Komuna Pishaj	Ndërtim KUZ, fshati Çekin, Lagjja Veriore (me 13,495,000L) dhe Lagjja jugore prej 2,722,000 L (shtesa)	16,217,000	8,108,500	8,108,500
5	Komuna Rajcë	Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Sutaj dhe lagjes Qendër të fshatit Rajcë	12,154,000	6,077,000	6,077,000
QARKU VLORË					
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit në lagjen 4, "Baba Rexhepi", dhe Lugu i Dardhës	224,000,000	112,000,000	112,000,000
7	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i ujësjellësit Dhërmi	55,306,366	30,882,138	24,424,228
8	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i ujësjellësit Fresco Dhërmi	32,300,000	22,610,000	9,690,000
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i ujësjellësit Ksamil - Vazhdim	35,018,893	24,513,225	10,505,668
10	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Projekti i ujësjellësit të fshatit Manastir - Vazhdim	23,314,481	16,320,137	6,994,344
		TOTALI	**451,246,740**	**250,000,000**	**201,246,740**

Shënim:
1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues). Kjo vlerë përfshin edhe vlerën e supervizim-kolaudimit të objekteve.
2. "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR për vitin 2015.

TABELA 2. PROJEKTET E PYLLËZIMIT DHE GJELBËRIMIT PËR FINANCIM NGA FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë projektit	Vlera e financimit 2014
QARKU KORÇË				
1	Komuna Buçimas	Pyllëzim i kurorës së gjelbër, Tushemisht	25,000,000	25,000,000
2	Bashkia Korçë	Sistemim i zonave të gjelbra midis blloqeve të banimit L15, L16	5,000,000	5,000,000
QARKU DURRËS				
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimeve i objektit Makaresh (Krastë-Krujë)	30,000,000	30,000,000
QARKU VLORË				
4	Bashkia Sarandë	Pyllëzimi dhe gjelbërimi i kurorës së qytetit të Sarandës	20,000,000	20,000,000
		TOTALI	**80,000,000**	**80,000,000**

Shënim:
1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues).
2. "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit

për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR për vitin 2015.

TABELA 3. PROJEKTI I ARTIT - KULTURËS PËR FINANCIM NGA FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë projektit	Vlera e financimit 2014	Vlera e financimit 2015
QARKU KORÇË					
1	Bashkia Korçë	Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës	60,000,000	38,819,000	21,181,000
		TOTALI	60,000,000	38,819,000	21,181,000

Shënim:
1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues).
2. "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR për vitin 2015.

TABELA 4. BASHKËFINANCIMI PËR PROJEKTIN E IPA ADRIATIK, NGA FUSHËN E ART-KULTURËS, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë projektit	Vlera e financimit 2014	Vlera e financimit 2015
QARKU SHKODËR					
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Restaurimi dhe muzealizimi i Fototekës Marubi (Shkodër)	14,000,000	7,000,000	7,000,000
		TOTALI	**14,000,000**	**7,00,000**	**7,000,000**

Shënim:
1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues).
2. "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR për vitin 2015.